REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

RAPORTI
I
VEPRIMTARISË
PËR
VITIN 2025

Maliq, Shkurt 2026

Raportimi i veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2025 është hartuar konform kërkesave të Urdhërit të Ministrit të Financave nr. 134, datrë 17.10.2025 "*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*", Manuali i Auditimit të Brendshëm i ndryshuar, kapitulli i IX-t, pika 4 "*Raportimi vjetor i veprimtarisë së NjAB*".

Më hollësisht po trajtojmë raportimin sipas strukturës së mëposhtëme.

Në hartimin e raportit të veprimtarisë të Auditimit të Brendshëm për vitin 2025, janë marrë në konsideratë të gjitha ndryshimet eventuale si në strukturën e institucionit dhe gjetjet dhe rekomanduimet e dhëna nga Auditimi i Jashtëm (KLSH). Vëmendje e veçantë nga Auditimi i Brendshëm po i kushtohet ndryshimeve strukturore të ndodhura në institucion gjatë muajve Janar-Dhjetor 2025, pasi për herë të parë në Bashkinë Maliq ka ndryshime rrënjësore në strukturë duke u krijuar një Drejtori Mbështetëse me strukturë, nipt dhe buxhet më vete. Duhet theksuar se për këtë periudhë raportuese ndryshimet e strukturës kanë qënë të shpeshta dhe rrënjësore, edhe pse në fillim të vitit 2025 u krijua Drejtoria Mbështetëse e Shërbimeve ajo në Dhjetor 2025 u shkri si drejtori dhe kaloi përsëri siç ishte në vitin 2024. Ndryshimet e shpejta dhe rrënjësore në institucion ndikojnë negativisht në ecurinë e punës në instuitucion, po kështu dhe në efektivitetin e punës të strukturës së auditimit të brendshëm. Vendosja e një strukture unike dhe të qëndrueshme del si proritet i rëndësishëm i menaxhimit të lartë për periudhat në vijim.

STRUKTURA E RAPORTIT VJETOR 2025 E NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM BASHKIA MALIQ.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

II. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI NJËSINË E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

III. REALIZIMI I PLANIT VJETOR TË AUDITIMEVE

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

V. VLERËSIMI I IMPLEMENTIMIT TË REKOMANDIMEVE

VI. VLERËSIMI I SISTEMEVE TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE MENAXHIMIT TË RISKUT

VII. PROGRAMI I SIGURIMIT TË CILËSISË DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL

IX. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME

VIII. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME

IX. PASQYRA SHOQËRUESE TË TË DHËNAVE

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- *Qëllimi i raportit*

Qëllimi i raportit është të hartojë në mënyrë sintetike gjithë veprimtarinë e NJAB për vitin 2025 me synim përmbledhjen e aktiviteteve kryesore, përmbledhjen e gjetjeve dhe rekomandimeve,

vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e riskut si dhe dhenien e opinionit të përgjithshëm mbi gjendjen e kontrollit të brendshëm, raportimi në menaxhimi i lartë dhe në Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

- *Përmbledhja e aktiviteteve kryesore të vitit*

Funksioni i Njësisë së Auditimit të Brendshëm është veprimtari e pavarur që ka ofruar siguri objektive dhe këshillim për menaxhimin e lartë të bashkisë (Kryetarin e Bashkisë) dhe subjekteve të varësisë për arritjen e objektivave të tyre, me kursim, dobi e frytshmëri.
Rezultatet dhe produktet e veprimtarisë së NjAB-së për vitin 2025, janë detajuar dhe analizuar në këtë raport dhe në pasqyrat e raportimit të veprimtarisë vjetore, të cilat për herë të parë hartohen sipas manualit të ri të miratuar në vitin 2025.
Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Maliq, gjatë vitit 2025 ka ushtruar veprimtarinë e saj në 8 subjekte, nga 8 subjekte të planifikuara, **realizimi i planit është 100%.**
Plani Strategjik dhe vjetor për vitin 2025 është miratuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresën nr. 4368/2 prot, datë 21.10.2024 dhe nga ku rezulton se Plani i Angazhimeve të NjAB për vitin 2025 ka synuar për të audituar gjithsej 8 subjekte.
Plani i mësipërm është dërguar rregullisht në Drejtoria e Harmonizi mitt ë Auditimit të Brendshëm.
Në muajin Prill 2025 lindi nevoja e ndryshimit të Planit të Auditimit për shkak të një kërkesë nga menaxhimi i lartë mi cili kërkoj auditim në subjektin Kombinati Sheqerit Sha Maliq. Plani i angazhimeve për vitin 2025 me ndryshimet, u hartua i ri dhe u miratua nga Kryetari i Bashkisë me Shkresën nr. 2152, datë 10.04.2025, shkresë e cila është dërguar dhe në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. Në planin e ri të ndryshuar u hoq nga planifikimi subjekti Njësia Administrative Vreshtas dhe u zëvendësua me subjektin Kombinati Sheqerit Sha Maliq. Plani vjetor i ndryshuar u realizua 100%.
Është planifikuar dhe kryer auditimi **mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna** në subjektet e audituara gjatë vitit, ç'ka lidhet dhe me performancën e veprimtarisë audituese. Në vitin 2025 një vëmendje e veçantë nga NjAB iu kushtua dhe **auditimit mbi detyrimet e prapambetura dhe auditimi i zyres së BE** për të cilat janë futurë në programet tona të përvitëshme..
Nga auditimi i ushtruar në sistemet e veprimtarisë së subjekteve të audituara është vlerësuar në disa subjekte një nivel i lartë risku në sistemet e menaxhimit financiar, menaxhimin e aktiveve, në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e burimeve njerëzore. Konkretisht në përfundim të 8 auditimeve të planifikuara na rezultojnë 4 subjekte me risk të lartë,4 subjekte me risk të mesëm.

- *Përmbledhja e gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve*

Rekomandimet e dhëna për sistemet e audituara kanë synuar përmirësimin e dobësive dhe mangësive që gjenerojnë apo krijojnë mundësinë e shkeljeve apo mashtrimeve, me synim mospërsëritjen e tyre në të ardhmen.

Theksojmë se rekomandimet, për 8 subjektet e audituara janë gjithsej **61** të ndara në: **rekomandime me prioritet të lartë 32, rekomandime me prioritet të mesëm 28** dhe **rekomandime me prioritet të ulët 1. Të gjitha rekomandimet e dhëna janë pranuar nga subjektet audituese.**

Për t'ju dhënë rëndësinë e duhur rekomandimeve të NjAB nga ana e institucionit "Bashkia Maliq" është ndjekur dhe praktika që në përfundim të çdo auditimi, rekomandimet e lëna nga NjAB ju jepen subjekteve në formën e një urdhëri të veçantë të nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë. Gjatë vitit 2025 nga ana e Kryetarit të Bashkisë janë hartuar gjithësej 3 urdhëra për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga NJAB, të cilat ju janë adresuar të gjitha subjekteve të bashkisë që kanë qënë subjekt auditimi dhe dhe ju adresohet rekomandimi i dhënë dhe 2 urdhëra janë në process hartimi nga zyra juridike. Nuk është hartuar udhër vetëm për dy auditime e konkretisht për Zbatimin e detyrave të lëna nga NJAB dhe Detyrimet e Prapambetura, pasi për detyrat janë hartuar urdhëra më parë dhe për detyrimet e prapambetura ka një program dhe grafik të miratuar për shlyerjen e tyre.

Nevojitet të përmendet se, shkalla e zbatimit të rekomandimeve duhet të përmirësohet më tej.
Konkretisht për vitin 2025 janë dhënë gjithsej 61 rekomandime dhe deri më datën 10.02.2026 rezulton se 36 rekomandime janë zbatuar, 19 rekomandime janë në proces zbatimi dhe 6 rekomandime janë të pa zbatuara.
Zbatimi i tyre është rreth 59 %, por procesi i zbatimit të tyre vazhdon të ndiqet si nga vetë subjektet ashtu dhe nga Auditimi i Brendshëm. Më datën 10 Prill 2026 do tju raportojmë zyrtarisht për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lënë për vitin 2025, kjo në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr 42, datë 27.10.2020.

Është shumë e rëndësishme të përmendet se për çdo rast gjetje është dhënë dhe rekomandimi përkatës, për shkeljet e konstatuara janë përcaktuar përgjegjësitë. Përcaktimi i përgjegjësisë ka mundësuar që rekomandimet të adresohen gjithnjë e më mirë, të jenë të zbatueshme dhe efektive për subjektet e audituara.

- *Vlerësimi i përgjithshëm i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut.*

Gjatë vitit 2025 bazuar në auditimet e kryera rezulton se përgjithësisht kontrollet e brendëshme funksionojnë me përjashtim të rasteve të konstatuara në gjetjet dhe rekomandimet për çdo subjekt të audituar.Njësia e Auditimit të brendshëm gjatë punës në terren si dhe me raportet e auditimit ka dhënë këshillat dhe rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e funksionimit të kontrollit të brendshëm.Për periudhën 2025 janë evidentuar për çdo subjekt auditues dhe dobësitë në sistem. Nga ana e menaxhimit të lartë duhet të tregohet kujdes lidhur me menaxhimin e riskut, të caktohet kryetari i grupit të menaxhimit të riskur sipas legjislacionit në fuqi.(Kryetari i Grupit të Menaxhimit të Riskut duhet të jetë një nga Nënkryetarët e Bashkisë).

Në fazën e planifikimit Njësia e Auditimit të Brendshëm ka identifikuar fushat me risk të lartë mbi të cilat është bërë dhe plani vjetor i punës. Nga misionet e ushtruara në subjektet e audituara janë përcaktuar edhe risqet kryesore të identifikuara dhe trajtuara në raportet e auditimit për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse për menaxhimin e riskut.

Bazuar në auditimet e ushtruara gjatë vitit 2025 vlerësojmë me risk të lartë 4 subjekte e konkretisht Drejtoria e Të Ardhurave, Njësia Administrative Liboni, Kombinati i Sheqerit Sh.a Maliq dhe Zbatimi i detyrave të lëna nga KLSH dhe NJAB.
Nga auditimi është konstatuar se subjektet e audituara, kanë raportuar brenda afatit 30 ditor dhe kanë plotësuar dhe planin e veprimit.
Për të gjitha auditimet e realizuara në përfundim të raportit përfundimtar, për rekomandimet e AB është nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë urdhër i veçantë për zbatimin e tyre.
Raportimi për masat e marra nga ana e titullarëve të subjekteve të audituara është i mangët në caktimin e afateve dhe përgjegjësave gjithashtu dhe në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.
Një panoramë më të plotë dhe më të detajuar të dhënat janë të referuara në pasqyrën nr. 3, bashkëngjitur këtij raporti "*Përmbledhëse e gjetjeve me efekt nrgativ financiar sipas sistemeve për vitin 2025*".

- *Opinion i përgjithshëm mbi gjendjen e kontrollit të brendshëm.*

Nga auditimi i veprimtarisë në 8 subjektet e audituara janë konstatuar mangësi në sistemet e kontrollit të brendshëm që kanë lidhje me:

- Ndarjen e përgjegjësive në proceset e ndryshme për caktimin e urdhëruesit, zbatuesit dhe monitoruesit.
- Hartimin e gjurmës së auditimit për proceset e veprimtarisë nga fillimi deri në përfundim të tyre.
- Mospërshtatja e ndryshimeve në strukturë me rregulloren ekzistuese.

Në çdo raport përfundimtar nga ana e audituesve është analizuar dhe funksionimi i kontrollit të brendshëm dhe i është raportuar Titullarit të Institucionit lidhur me funksionimin e tij dhe dobësitë e mangësitë e vërejtura. Në përfundim të çdo auditimi nga ana e përgjegjësit të NJAB është përgatitur një Memo për Titullarin e Institucionit ku dhe i jepet vlerësimi për sistemin e kontrollit të brendshëm të subjektit auditues.

Sistemi i Kontrollit të Brendshëm funksionon në mënyrë ekfektive, por u gjetën disa mangësi, të cilat kanë apo mund të kenë ndikim të moderuar në objektivat e njësisë publike. Ka nevojë për marrjen e veprimeve për përmirsime në disa drejtime.

II. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI NJËSINË E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

- *Struktura organizative e NjAB*

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Maliq është e organizuar në nivel Sektori, i cili përbëhet nga 1 përgjegjës Sektori dhe 2 Specialistë.
Sektori ka varësi direkte nga Kryetari i Bashkisë Maliq.
Nga tre audites janë të çertifikuar 2 prej tyre dhe i treti ka aplikuar për certifikim, gjithashtu kanë ndjekur dhe trajnimin e detyrueshëm, bazuar në standartet ndërkombëtare dhe nenit 5 të Rregullores "*Trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik*" miratuar me Urdhërin nr. 260, datë 27.10.2020 "*Për disa ndryshime dhe një shtesë në urdhërin nr. 3, datë 08.01.2016 "Për miratimin e rregullores për trajnimin e vijueshëm profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik*".
Struktura ka funksionuar e plotë.

- *Personeli dhe kualifikimet profesionale*

Përbërja profesionale e audituesve të brendshëm është – **Financier i** Lartë (Përgjegjësi i Sektorit), **Financë-Kontabilitet** (Auditues) **dhe Menaxhim-Marketing**(Auditues).
Sipas **eksperiencës në punë** si audites të brendshëm përbërja jepet në tabelën më poshtë:



- *Kapacitetet teknike dhe zhvillimi profesional gjatë vitit*

NJAB për vitin 2025 ka ngritur kapacitetet teknike të saj duke kryer punën në terrën, përsosur atë dhe ndjekur në mënyrë të vazhdueshme të gjitha trajnimet në fushën e auditimit dhe të financave lokale.

Misioni i auditimit të brendshëm është të mbështesë menaxhimin e lartë për kryerjen e përgjegjësive të tyre. Këtë mision ai e realizon duke:

1. Mbështetur menaxhimin e organizatës publike për arritjen e objektivave.

2. Kryer vlerësime të pavarura të sistemeve, bazuar në standartet profesionale të miratuara.

3. Ngritur nivelin profesional të audituesve.

Auditimi i brendshëm ndihmon menaxhimin duke ofruar analiza, rekomandime, këshillime dhe informacione lidhur me veprimtaritë që ai ka vlerësuar sipas objektivave në subjektet e audituara.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Maliq, bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.129, datë 26.12.2024, ndryshuar me vendimin nr.99, datë 26.08.2025, lidhur me strukturën organizative, për periudhën Janar-Dhjetor 2025 mbulon me auditim gjithsej 25 subjekte si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i subjektit
1	Njësia Administrative Libonik
2	Njësia Administrative Pojan
3	Njësia Administrative Vreshtas
4	Njësia Administrative Pirg
5	Njësia Administrative Gorë
6	Njësia Administrative Moglicë
7	Zyra e Integrimit Europian dhe Kordinimit të Ndihmës së Huaj
8	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
9	Drejtoria e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore
10	Drejtoria Juridike dhe Prokurimet Publike
11	Drejtoria e Planifikimit,Kontrollit dhe Zhvillimit të Teritorit
12	Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve
13	Inspektoriati Vendor I Mbrojtjes së Teritorit+ Mjedisit (IVMT)
14	Sektori i Emergjencave Civile
15	Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit dhe Shëndetësisë
16	Sektori Mbështetës dhe pajisjeve nën presion
17	Policia Bashkiake
18	Gjendja Civile
19	Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi
20	Agjensia e Shërbimeve Mbështetëse.
21	Zyra e Bashkëqeverisjes dhe Performancës
22	Drejtoria e Burimeve Njerzore dhe Mardhënieve me Publikun
23	Kombinati I Sheqerit Sh.a Maliq
24	Klubi I Futbollit Sh.a Maliq
25	Bashkia Maliq Zbatimi I detyrave te lëna nga KLSH dhe NJAB

III. REALIZIMI I PLANIT VJETOR TË AUDITIMEVE

Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese(Auditime të planifikuara,Auditime jashtë planit,Auditime të ndjekjes së rekomandimeve dhe shmangjet nga plani vjetor i auditimit)

Në planin e vitit 2025 janë programuar për auditim 8 subjekte dhe në fakt janë realizuar 8 auditime, brenda vitit. Realizimi i planit të auditimit përsa i përket numrit total është në masën 100 %.
Auditime të planifikuara 8.
Auditime të realizuara 8, nga të cilat një auditim ka qënë jashtë planit, por është hequr një subjekt dhe vendosur një subjekt tjetër.
Plani Strategjik dhe vjetor 2025 është miratuar dhe dërguar me shkresën nr.4368/2, datë 21.10.2024, por më von me kërkesën e menaxhimit të lartë është bërë një ndryshim:
-Eshtë hequr nga plani . auditimit subjekti Njësia Administrative Vreshtas .
-Eshte vendosur në planin e auditimit subjekti Kombinati i Sheqerit Sh.a Maliq.
Plani i ri i ndryshuar, është miratuar dhe dorëzuar me shkresën nr.2152/1, datë 10.04.2025.

Në skemën më poshtë jepet realizimi i planit vjetor për vitet 2024 e 2025.

Sqarojmë se në dosjet e auditimeve të vitit 2025 vetëm një subjekt u evadua raporti përfundimtar në muajin Janar 2026.



Analiza e misioneve të auditimit, objektivave të auditimeve

Për vitin 2025 janë programuar misione auditimi nga të cilat janë: 3 auditime përputhshmërie, 1 auditim (Financiar) 4 auditime me bazë sistemi.
Për vitin 2025, u audituan subjektet, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit(Detyrimet e prapambetura,veprimet e kryera me arkë, bangë,magazinë), Zbatimi i detyrave të lëna nga NjAB në vitin 2024, Drejtoria Juridike Burimeve Njerëzore dhe Prokurimeve Publike, Drejtoria e të

Ardhurave,Njësia Administrative Pojan dhe Libonik,Kombinati i Sheqerit Sh.a Maliq dhe Zyra e Integrimit Europian dhe Kordinimit të Ndihmës së Huaj

Për vitin 2025, auditimet me peshë të rëndësishme kanë qenë Drejtoria Juridike Burimeve Njerëzore dhe Prokurimeve Publike, Drejtoria e të Ardhurave,Njësia Administrative Pojan dhe Libonik,Kombinati i Sheqerit Sh.a Maliq.

III. GJETJET DHE REKOMANDIMET

- *Përmbledhje e gjetjeve kryesore sipas fushave/proceseve të audituara.*

Janë konstatuar shkelje në *fushën e Tatim-Taksave (Mungesë të Ardhurash).*

Nga auditimet ka rezultuar që në disa raste nuk zbatoheshin tarifat e vendosura në paketën fiskale duke bërë devijime për tarifat mbi aktete, duke arkëtuar në disa raste dhe më tepër nga kufijtë e vendosur me vendim Këshillit Bashkiak. Problematikë ne këtë sektor është mosarkëtimi i borxhit të akumuluar ndër vite.

Nga auditimet e kryera në total rezultojnë mungesë të ardhurash në vlerën 107.588 mijë lekë vlerë borxhi e akumuluar dhjetë vitet e fundit. Shifra e mësipërme është e detajuar konkretisht:

-Taksa dhe tarifa lokale nga familjarët në vlerën 61.699 mijë lekë në 9663 raste.
-Taksa e tokës bujqësore nga familjarët për 36.561 mijë lekë në 9663 raste.
-Taksa e ndikimit në infrastrukturë 7.551 mijë lekë në 187 raste.
-Taksa e tarifa nga subjektet private 1.542 mijë lekë në 41 raste
-Detyrime nga subjektet Taksi 235 mijë lekë në 12 raste.

- *Rekomandimet e dhëna*

Nga ana e audituesve për çdo gjetje të konstatuar është lënë rekomandimi përkatës për përmirësimin e fushës në të ardhmen. Për 8 subjektet e audituara janë lënë **gjithsej 61 rekomandime afërsisht 8 rekomandime për subjekt.**

Rekomandimet janë lënë për përmirësimin e sistemeve të veprimtarisë së subjektit me qëllimin menaxhimin e riskut.

Nga ana e NJAB rekomandimet janë dhënë të plota, të qarta, të adresuara dhe synojnë përmirësimin e veprimtarisë dhe përformancës së kontrollit të brendshëm.

Në subjektet e audituara janë marrë në analizë gjetjet e konstatuara, janë përcaktuar përgjegjësitë dhe janë lënë rekomandimet për menaxhimin e riskut në të ardhmen. Janë nxjerrë në pah hallkat më të dobëta dhe jo funksionale të sistemit, të cilat kanë sjellë dhe pasojat e tyre negative në përdorimin me dobi, kursim dhe frytshmëri të fondeve publike.

Gjetjet kryesore të rezultuara nga auditimi i 8 subjekteve lidhen kryesisht me mosfunksionimin siç duhet të sistemit të kontrollit të brendshëm, në sistemin e programimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat lokale, menaxhimin e fondeve nga donatorët e huaj, shpenzimeve të realizuara nga të cilat mund ti përmendim si më poshtë;

- *Prioriteti i rekomandimeve (i Lartë , i mesëm i ulët)*

Nga 61 rekomandime të dhëna në total për vitin 2025 rezulton:

-Rekomandim me prioritet të lartë 32.
-Rekomandim me prioritet të mesëm 28.
-Rekomandim me prioritet të ulët 1.

Çështjet e dërguara për investigim

Gjatë vitit 2025 nuk ka patur asnjë çështje për investigim.

V. VLERËSIMI I IMPLEMENTIMIT TË REKOMANDIMEVE

Për vitin 2025 ecuria e rekomandimeve ka qënë si më poshtë:

-Numuri total i rekomandimeve të dhëna 61.
-Rekomandime të pranuara 61.
-Rekomandime ta papranuara 0.
-Rekomandime pjesërit të pranuara 0.

Në fillim të vitit 2026 bazuar në planin e punës është planifikuar dhe auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2025. Sqarojmë se në të gjitha subjektet e audituara një pikë e programit të punës ka qenë zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme nga ku ka rezultuar se ka rekomandime që nuk janë zbatuar.

Duhet një vëmendje më e madhe nga ana e subjekteve të audituara lidhur me rëndësinë dhe përgjegjshmërinë që duhet të tregojnë lidhur me rekomandimet e AB.

Nga vlerësimi paraprak i zbatimit të rekomandimeve të lëna për vitin 2025 rezulton se ato janë realizuar afërsisht 59%.

Shkaqet e moszbatimit të rekomandimeve të lëna janë për arsye:

- Të ndryshimit të stafit, largimit nga puna të personave për të cilët janë lënë rekomandime.

- Mangësi në njohjen dhe azhornimin me aktet në fuqi.

- Ristrukturimi i disa drejtorive të cilat u grupuan në Sektorin Mbështetës duke kaluar me nipt dhe llogari më vete.

- Ndryshimi i shpeshtë i strukturës Brenda vitit ushtrimor.

- Ndryshimi i drejtuesve të progarmeve buxhetore.

VI. VLERËSIMI I SISTEMEVE TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE MENAXHIMIT TË RISKUT

-Vlerësimi i përgjithshëm i funksionimit të kontrolleve.

Gjatë vitit 2025 bazuar në auditimet e kryera rezulton se përgjithësisht kontrollet e brendëshme funksionojnë me përjashtim të rasteve të konstatuara në gjetjet dhe rekomandimet për çdo subjekt të audituar.Njësia e Auditimit të brendshëm gjatë punës në terren si dhe me raportet e auditimit ka dhënë këshillat dhe rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e funksionimit të kontrollit të brendshëm.

-Dobësitë e identifikuara në sistem.

Për periudhën 2025 janë evidentuar për çdo subjekt audites dhe dobësitë në sistem.
Konkretisht janë konstatuar 61 gjetje dhe janë dhënë po kaq dhe rekomandime, të cilat janë identifikuar dobësitë në sisteme e nënsisteme nga të cilat 30% janë në fushën e të Ardhurave, 26% ne fushën e detyrimeve të prapambetura, 16% në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe pjesa tjetër në sisteme e nënsiteme të paraqitura në pasqyrën nr.4.

-Opinioni i auditimit mbi nivelin e besueshmërisë së kontrolleve të brendëshme.

Në zbatim të shkresës tuaj nr. 18532 prot datë 31.12.2025, *"Mbi raportimin e veprimtarisë së NJAB-së për vitin 2025"*, si dhe bazuar në standartin nr 2450 "Opinonet e përgjithshme Standartet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm" po japim opinionin e përgjithshëm mbi efektivitetin e Sistemit të Kontrollit të brendshëm.
Për dhënien e ktij opinioni jemi bazuar në strategjinë, objektivat, dhe rrisqet e Bashkisë si dhe në auditimet e kryera gjatë viteve të mëparshme dhe vitit të kaluar 2025, jemi mbështetur dhe në gjetjet dhe rekomandimet e lëna nga KLSH në auditimet e fundit.
Bazuar në sa thamë më sipër si dhe në pritshmëritë e menaxhimit të lartë opinioni jonë si strukturë audituese për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm është si më poshtë:

Opinion i Vlerësimit të Sistemit të Kontrollove të Brendshëm	**Përshkrimi i Opininit Baza e Opinionit**
Niveli 2-Sistem Pjesërisht Efektiv: "Sistemi i Kontrollit të Brendshëm funksionon evektivisht/mirë, por ka nevojë për disa përmirësime të sistemeve dhe procedurave". **E verdhë**	Sistemi i Kontrollit të Brendshëm funksionon në mënyrë ekfektive, por u gjetën disa mangësi, të cilat kanë apo mund të kenë ndikim të moderuar në objektivat e njësisë publike. Ka nevojë për marrjen e veprimeve për përmirsime në disa drejtime.

VII. PROGRAMI I SIGURIMIT TË CILËSISË DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL

-Veprimtari për zhvillimin professional të audituesve.

Në vitin 2025 nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm janë kryer njësërë veprimtarish në fushën e auditimit , janë kryer disa trajnime onlain të cilat janë ndjekur rregullisht nga të tre punonjësit e NJAB. Veprimtaritë e mëipërme kanë ndikuar në ngritjen profesionale të audituesve.

-Trajnime dhe certifikime të realizuara.

Në Dhjetor të vitit 2025 u organizua Trajnim i rregullt tre ditor lidhur me ndryshimet të bëra në Manualin e Auditimit, për të cilën audituesit u pajisën me certifikatën përkatëse. Nga ana e NJAB janë ndjekur të gjitha trajnimet që kanë të bëjnë me auditimin dhe financat lokale.

-Zbatimi i programit të kontrollit të cilësisë së auditimit.

Përgjegjësi i Njësisë së Auditimit ka kryer dhe rishikimin e cilësisë së auditimeve të kryera. Rishikimi i cilësisë është kryer hap pas hapi deri në evadimin e dosjes për të krijuar një siguri të arsyeshme në përputhje me standartet dhe praktikat profesionale të auditimit të brendshëm, të kartës së auditimit e standarteve të tjera të zbatueshme.

Për auditimet e kryera në vitin 2025 është plotësuar:

-Aneksi 1.1: Lista e kontrollit për monitorimin e brendshëm të aktivitetit të auditimit të brendshëm

-Audituesi i brendshëm (Standarti 2200-2400).

-Aneksi 1.2:Lista e kontrollit për monitorimin e brendshëm të aktivitetit të auditimit të brendshëm

-Përgjegjësi i grupit të auditimit (Standarti 2200-2500-Përgjegjësi i grupit të auditimit).

-Aneksi 1.3:Lista e kontrollit për monitorimin e brenshëm të aktivitetit të auditimit të brendshëm

-Drejtuesi i NJAB (Standarti 2200-2500 Zonat e përgjithëshme-Drejtuesi i NJAB).

-Aneksi nr 2:Lista e kontrollit për të vlerësuar cilësinë e kritereve gjatë vlerësimit periodik të cilësisë së brendëshme.

-Aneksi 3: Model studimi i subjektit të audituar-Fedback.

-Në vitin 2026 rishikimi i cilësisë së auditimit do të kryet në përshtatje me Manualin e ri të Auditimit.

VIII. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME

- *Konkluzione.*

Një maksimizim i funksionit të auditimit të brendshëm do të thotë rezultate, përmirësim dhe vlerë. Vlera e auditimit të brendshëm krahas vlerësimeve objektive dhe të pavarura matet nga aftësia e tij për të nxitur dhe udhëhequr ndryshime pozitive dhe përmirësime të mëtejshme.

Niveli i cilësisë së punës audituese dhe profesionalizmi i audituesve ka impakt të drejpërdrejtë në forcimin e rolit dhe pozitave të auditimit në subjektet ku ai funksionon. Duke mbështetur menaxhimin me vlerësime objektive dhe të pavarura dhe për më tepër duke ofruar rekomandime efektive, auditimi i brendshëm shton vlerën e vetë auditimit e si rrjedhojë dhe të subjektit të audituar.

1. Vlerësimi i riskut është një proces që kërkon vëmendje të shtuar në periudhat e ardhëshme, nga të gjitha strukturat e Kontrollit të Brendshëm dhe NJAB-së.

2. Eksperienca e pakët e punës së specialistëve si në auditim dhe eksperiencën totale të punës, i strukturës së auditit për një periudhë të gjatë kohe ndikon në realizimin e objektivave. Aktualisht NJAB ka një specialist të parcertifikuar, për të cilin mendojmë se do të regjistrohet në vitin 2026.

3. Ndryshimi disa herë brenda vitit i strukturës organizative të Bashkisë përbën risk në realizimin e objektivave të institucionit dhe vështirësi në punën audituese të NJAB-së.

Sa më sipër janë kufizime që ndikojnë në realizimin e veprimtarisë së auditimit.

-Rekomandime të përgjithëshme.

Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm për vitin e ardhshëm rekomasndojmë:

1- Rritja e cilësisë së raportimit, nëpërmjet forcimit të procesit të rishikimit të brendshëm të cilësisë.

2- Përmirësimin e cilësisë së rekomandimeve, me qëllim zbatimin 100% të tyre nga njësitë e audituara.

3- Kërkimi nga titullarët e institucioneve publike të përgatitin në kohë planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të marra nga auditimi i brendshëm dhe të raportojnë periodikisht deri në zbatimin e plotë të tyre.

4- Rritja e aftësisë së audituesve nëpërmjet trajnimit në fusha konkrete sipas nevojave.

Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së kontollit të të brendshëm për vitin e ardhshëm rekomasndojmë:

1-Menaxhimi i lartë të rrisi kërkesën ndaj strukturave të kontrollit të brendshëm për realizimin e të gjitha objektivave dhe programeve buxhetore si dhe rritjen e efektivitetit të tyre.

2-Menaxhimi i Lartë të hartojë struktura të qëndrushme dhe funksionale me synim bashkërendimin e punës së tyre dhe realizimin e objektivave.
3-Të hartohet rregullore e re e instucionit e cila të përshatet me strukturën organizative të ndryshuar.
4-Të rishikohen me prioritet politikat në drejtim të arkëtimit dhe menaxhimit nga taksat dhe tarifat vendore, të kontraktohen për arkëtim agjentët e ndryshëm tatimor dhe të hiqet praktika e arkëtimit të tyre me arkëtar shëtitës pasi risku në këtë fushë mbetet i lartë.
5-Të menaxhohen dhe administrohen me efektivitet të gjitha pronat e Bashkisë, të planifikohen fondet përkatëse për regjistrimin e tyre, të rritet vëmendja ne drejtim të dhënies me qira të aseteve dhe pronave sidomos të pasurive pyjore, me synim rritjen e të ardhurave në buxhetin e Bashkisë.
6-Të përfundojë hartimi i gjurmëve të auditimit nga të gjitha strukturat e kontrollit të brendshëm.

IX. PASQYRA SHOQËRUESE TË TË DHËNAVE

Pasqyrat janë bashkangjitur si më poshtë:

1. Të dhëna për audituesit e brendshëm;
2. Realizimi i angazhimeve të auditimit;
3. Gjetjet sipas fushës apo sistemit;
4. Përmbledhëse e gjetjeve sipas sistemeve dhe nënsistemeve;
5. Çështjet e dërguara për inspektim për vitin 2025

Bashkangjitur dhe pyetësori i vetëvlerësimit

Afrim Beqiraj

Përgjegjës i Njësisë së Auditimit të Brendshëm

INSTITUCIONI: BASHKIA MALIQ
NIVELI I ORGANIZIMIT TË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM: SEKTOR
VARËSIA E NJËSISË SË AUDITIMIT BRENDSHËM: I PAVARUR
NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË : 3 (PUNONJËS)

Pasyra 1

Të dhënat për burimet njerëzore të auditimit të brendshëm për vitin 2025

NR	EMËR MBIEMËR	TË DHËNA PËR AUDITUESIT E BRENDSHËM										
		Pozicioni	Emërimi nr.____ dt. ____	Arsimimi		Eksperienca e Punës		Zhvillimi Profesional				
								Çertifikimi				Trajnime në fushën AB nga Institucione Kombëtare ose Ndërkombëtare
				Arsimi Bazë	Niveli i Diplomës	Vitet e punës Gjithsej	Vitet e punës në AB	I pa certifikuar	Në proces certifikimi	I certifikuar në vitin	Certifikatë Ndërkombëtare	
a	b	1	2	3	4	5	6	7.1	7.2	7.3	7.4	7.5
1	Afrim Beqiraj	Përgjegjës	Nr 5068/1 datë 25.10.2016	Finacier i lartë	Master shkenco	36	17	jo	jo	2008	jo	po
2	Emiljan Kodra	Spec.Auditimi	Nr 07 datë 06.03.2020	Menaxhim-Marketi	Master shkenco	11	6	jo	jo	2021	jo	po
3	Klea Prifti (Dautllari)	Spec.Auditimi	Nr 605 datë 07.11.2022	Financë-Kontabilite	Master shkenco	4	3	po	po	jo	jo	po
4												
5												
6												
